



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Ismail Kadare****Pa ty**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kjo poezi është shkruar me rimë ABAB.
- Një përdorim i tillë i jep poezisë muzikalitet.

1 pikë Nëse gjen rimën më të cilën është shkruar kjo poezi.

DHE

1 pikë Nëse gjen se çfarë i jep poezisë një përdorim i tillë.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Peizazhi që sjell kjo poezi është ai i vjeshtës ose i fundvjeshtës dhe i fillimit të dimrit, është dhe muzg e fryn erë e ftohtë. Një peizazh ku ndihet shkretimi, ftohtësia dhe vetmia.

Figurat e stilistikës që sugjerojnë pikërisht këtë kalim të stinëve dhe krijimin e këtij peizazhi janë:

- **Epiteti:** drurët *gjetherënës*, erë *e ftohtë*, stof *i keq*, mullarë *të gjysmuar*, udhws *sw pafundme*;
- **Krahasim:** *Si stof i keq u zbeh blerimi*
- **Metafora:** *u zbeh blerimi, ku zverdhin drurwt gjetherwnws, mbi gjokse perdesht tani tundet*
- **Epitet metaforik dhe inversion:** *i arti medaljon i hënës*

Pikë të plota

1 pikë Nëse shkruan atmosferën e veçantë që sjell kjo poezi.

DHE

2 pikë Nëse e shpjegon atmosferën përmes dy figurave të stilistikës.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse identifikon vetëm atmosferën përmes një figure të stilistikës.

OSE

2 pikë Nëse identifikon vetëm dy figurat, por bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon atmosferën, por pa e ilustruar me figura të stilistikës.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një figurë të stilistikës bashkë me ilustrimin përkatës.

OSE

1 pikë Nëse gjen dy figurat e stilistikës, por pa ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse gjen një figurë të stilistikës, por pa ilustrim, përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Gjendja shpirtërore që po përjeton heroi lirik është tepër e rënduar dhe e trishtuar.
- Ai ndihet i braktisur, i harruar, i vetmuar.
- I pushtuar nga një ftohtësi që është në natyrë dhe në shpirtin e tij.

II

- Shkaku i kësaj gjendjeje është vetmia, largimi i vajzës së dashur dhe ftohtësia që ajo ka shkaktuar me largimin e saj.

1 pikë Nëse shkruan gjendjen shpirtërore që po përjeton heroi lirik.

1 pikë Nëse gjen se çfarë e ka shkaktuar atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 11 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) **pjesa e ligjëratës:** mbiemër

Formimi: gjethe+ rënës ose është fjalë e përbërë.

b) **Gjymtyrë homogjene:** toka, pylli, reja

1 pikë a) Nëse gjen pjesën e ligjëratës.

1 pikë Nëse gjen mënyrën e formimit.

1 pikë b) Nëse gjen gjymtyrët homogjene.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 4 pikë**Model përgjigjeje**

a) **Imazhi romantik:** vetë përdorimi i hënës si figurë është element romantik, heroi që ulet përmbi pellgje ku pasqyrohet hëna, hëna e artë që pasqyrohet në perde, hëna si medaljon në kraharor.

Imazhi modern: hëna si medaljon i ftohtë, që i mbetet heroit në grykë, që kthehet në pengesë.

b) Në imazhin modern hëna ofrohet e materializuar në medaljon të ftohtë, shndërrohet në metal, shndërrohet në ngërç për poetin që vuan. Hëna nuk është më e reflektuar diku (sy, kraharor etj), por ka ngecur në grykën e heroit lirik.

Ndjesia që sugjeron ky përdorim është ai i ngërçit, marrjes së frymës, angësisë, i mbytyjes, mungesës së ajrit, pengesës, etj (do të pranohet një ndjesi që sugjeron).

1 pikë Nëse gjen se në cilin moment të poezisë ofrohet imazhi romantik (do të pranohet edhe nëse ofrohet varg ose vargje nga poezia, ku shfaqet ky moment).

1 pikë Nëse gjen se në cilin moment të poezisë ofrohet imazhi modern (do të pranohet edhe nëse ofrohet varg ose vargje nga poezia ku shfaqet ky moment).

1 pikë Nëse gjen se si ofrohet figura e hënës në imazhin modern

1 pikë Nëse gjen ndjesinë që sugjeron ky përdorim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

PJESA II

Franc KAFKA

PROCESI

Pyetja 13 D 1 pikë

Pyetja 14 C 1 pikë

Pyetja 15 A 1 pikë

Pyetja 16 D 1 pikë

Pyetja 17 C 1 pikë

Pyetja 18 D 1 pikë

Pyetja 19 2 pikë

Model përgjigjeje

- Në këtë skenë ngjarja ndodh jashtë qytetit, në një gurore të braktisur. Është natë dhe kudo sundon errësira.
- Funksioni i kësaj zgjedhjeje: krijon një ndjesi ankthi, braktisjeje, vetmie, idenë se diçka e frikshme do të ndodhë, pamundësinë për të shpëtuar.

1 pikë Nëse tregon se në ç' rrethana ndodh kjo ngjarje, pra vendi dhe koha.

1 pikë Nëse tregon se cili është funksioni artistik i kësaj zgjedhjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Dy ekzekutuesit (xhelatët) e shikojnë si detyrë që duhej kryer. Xhelatët janë të qetë në të gjitha rrethanat, ata nuk janë emocionalë, pasi atëherë nuk do ta kryenin dot këtë *detyrë*, kjo punë për ata është rutinë.

Jozef. K i mungon *energja pozitive*, ngaqë ka ndjesinë e fajit dhe nuk arrin ta kuptojë se ç'po ndodh me të.

1 pikë Nëse shpjegon qetësinë që karakterizon dy xhelatët.

1 pikë Nëse shpjegon qetësinë që karakterizon Jozef K.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 **2 pikë****Model përgjigjeje**

a) Detaji i burrit në dritare është një moment i rastësishëm që e lidh Jozef K. me jetën, me një fije shpresë për shpëtim.

b) Të gjitha pikëpyetjet rreth burrit në dritare zbulojnë dëshirën për jetën. Është pragu që ndan jetën nga vdekja, që provokon ringjalljen e një shprese.

Ose

Pamja e njeriut në dritare mund të mos ketë fare lidhje me të, por të gjitha pyetjet rrjedhin nga: "...ama dëshira për të jetuar ishte shumë e madhe." . Jozef K. i lind iluzioni se ndoshta edhe mund të kishte drejtësi, mund të shpëtonte.

1 pikë Nëse gjen se ç' nënkupton ky detaj.

DHE

1 pikë Nëse interpreton të gjitha pikëpyetjet që i linden Jozef K. në këtë çast.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Efektin e tragjizmit e jep një fjalë e vetme *si qen*. Vetë fjala krijon një asosacion të fortë. Jozef K. vdes vetëm, i ekzekutuar në mënyrën më antinjerëzore të mundshme dhe pa e ditur se përse.
- Jozef K. është i vetëdijshëm për fundin e tij, vetëm jo në këtë mënyrë, sikur të ishte askush, pa vlerë. *Si qen* është zëri i tij i protestës kundër këtij fundi kaq ç'njerëzor.

Përgjigje e pjesshme

- Efektin e tragjizmit e krijon fjala *si qen*. Më duket fjalë e rëndë.
- Vritet pa asnjë arsye, kot.
- Vrasja është makabre, si të vrasësh një kafshë.

OSE

Efektin e tragjizmit e jep i gjithë përshkrimi skenës së vrasjes. Kafka krijon imazhe të fuqishme përmes përdorimit të detajeve të hollësishme si: *gryka, thika që ngulet në zemër, rrotullohet, si qen*. Të gjitha së bashku e bëjnë skenën më makabre si dhe theksojnë absurditetin e fundit të Jozef K.

Përgjigje e pjesshme

- Efektin e tragjizmit e krijon e gjithë skena e vrasjes, sepse ka shumë detaje.
- Krijon përshtypje **më të plotë** e gjithë skena. (*Theksohet fjala e plotë*)
- Detajet e përdorura janë më mbresëlënëse.

2 pikë Nëse argumenton plotësisht se kush e jep efektin e tragjizmit.

OSE

1 pikë Nëse argumenton pjesërisht se kush e jep efektin e tragjizmit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Shënim:

Nxënësi mund të argumentojë për të dy anët e pyetjes dhe përgjigja do të vlerësohet në cilësinë e argumentit që paraqet.

Pyetja 23 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) Ngjarja rrëfëhet në vetën e tretë. Rrëfimi është në këtë vetë, sepse e bën më të lehtë rrëfimin e ngjarjeve në distancë. Kjo e lejon lexuesin që të krijojë vetë përshtypjet dhe ndjesitë e veta, pa u nxitur nga autori. Në këtë mënyrë, lexuesi ka mundësinë të krijojë në imagjinatë një përvojë që është po aq shkatërruese dhe çorientuese sa është edhe për Jozef K.

b) Foljet janë përdorur në kohën e së kryerës së thjeshtë.

1 pikë Nëse gjen vetën në të cilën rrëfëhet ngjarja.

1 pikë Nëse shpjegon pse rrëfimi është në këtë vetë.

1 pikë Nëse gjen kohën në të cilën janë vendosur foljet në fragment.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **4 pikë****Model përgjigjeje**

a) Elemente që nuk rrëfihen: vendi, emri i qytetit, pamja e ekzekutuesve, emrat e tyre, profesioni i Jozef K. nuk është i qartë, arsyeja pse po vritet, Jozef K. nuk ka një mbiemër të plotë, nuk dihet se kush i dërgon dy zotërinjtë.

b) Situata absurde: Vrasja (ekzekutimi) e Jozef K. pa asnjë arsye, veprimet absurde të dy xhelatëve, që në dukje janë të vendosura dhe energjike.

Shpjegimi:

- Jozef K. ekzekutohet pa e ditur as vetë se pse. Vrasja e tij është aq mizore sa na çon në pyetje se ç'gjë të tmerrshme paska bërë që të meritojë një dënim kaq të rëndë.
- Veprimet e dy xhelatëve nuk mund të marrin asnjë shpjegim të arsyeshëm, pse ata sillen në atë mënyrë. Nga njëra anë ata shkojnë të kryejnë një ekzekutim (edhe pse nuk është dhënë nga gjyqtarët asnjë vendim) nga ana tjetër kryejnë veprime pa asnjë kuptim. Në nëntekst ky është abuzimi me pushtetin. Ashtu si sistemi është një sistem i mbyllur, që vepron në fshehtësi të plotë dhe sipas rregullave misterioze, po ashtu edhe ekzekutimi i K. duket se vjen nga askund dhe pa asnjë justifikim.

2 pikë Nëse gjen dy elemente që nuk zbulohen gjatë rrëfimit.

DHE

1 pikë Nëse gjen absurdin në këtë skenë

DHE

1 pikë Nëse shpjegon absurdin në këtë skenë.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen një element që nuk zbulohet gjatë rrëfimit.

DHE

1 pikë Nëse gjen absurdin në këtë skenë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, gjen elemente dhe situata të tjera absurde që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton pse fundi i Jozef K. është konsideruar tragjik.
- shtjellon se çfarë është tragjike.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë**1 pikë Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë**(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.